



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 402/2 prot.,

Datë 24.02.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-48995-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për Forcat e Armatosura, ndarë në 4 (katër) Lote”, me fond limit 154,786,352 lekë pa TVSH, Loti I me Nr. REF-48998-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 5001 (AFA) Tiranë*”, me fond limit të lotit 94,856,552 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 14.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Ankimues:

“NIKA” SHPK

Adresa: Lagjja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu”,
Godinë 8-katëshe, Kati i I-rë, Zona Kadastrale 8593, Shkodër.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara

Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë.

Në datën 23.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me numër 402 prot., dhe numër elektronik A/2023/2903 e operatorit ekonomike operatorit ekonomik “NIKA” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-48995-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*”, për Forcat e Armatosura, ndarë në 4 (katër) Lote”, me fond limit 154,786,352 lekë pa TVSH, Loti I me Nr. REF-48998-11-07-2022, me objekt: “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 5001 (AFA) Tiranë*”, me fond limit të lotit 94,856,552 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 14.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “NIKA” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “NIKA” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 402 prot., datë 23.02.2023 dhe numër elektronik A/2023/2903.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

- Ofertuesi nuk plotëson pikën 5, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit germa c), pasi nga verifikimet e listepagesave janar 2021 - dhjetor 2022 te paraqitura ne vijim te kerkeses per informacion nr. 218 prot. Date 06.02.2023, ka rezultuar se ka paraqitur dokumentacion te parregullt ne lidhje me stafin teknik “Ndhimes Kuzhinier”. Konkretisht, per punonjesit A. Gj., L.M., E.N. dhe H.M., ne SPE ne ditën e hapjes se ofertave, jane paraqitur librezat e punes dhe kontratat e punes date 05.01.2021 me funksionin “Ndhimes ne kuzhine”, nderkohe qe, pas verifikimit te AK, te gjithë keta punonjes, qe nga muaji mars 2021 deri ne dhjetor 2022, figurojne te regjistruar perkatesisht me profesionet: “karpentier”, “copetues guri”, “bojaxhi” dhe “instalues per kondicionere”, dhe jo “ndihmes kuzhinier” sic eshte kerkuar ne DST dhe sic jane deklaruar ne SPE nga ofertuesi ne Kontratat e punes dhe librezat e punes perkatese. Bazuar ne paragrafin e fundit te Shtojces 8 te DST, “Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 24.02.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri